



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:121150

Datë: 30.05.2024

Numri i dokumentit: 05759092

P.nr..../..

GJYKATA THEMELORE NË PEJË DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL gjyqtari i vetëm gjykues Musë Povataj, me pjesëmarrje të bashkëpunëtores profesionale Edona Berisha Kastrati, në çështjen penale ndaj të pandehurit X.... P....., për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 314 par. 1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë Departamenti i Përgjithshëm PP/II nr.1093/22 të datës 13.06.2022, jashtë seancës gjyqësore me datë bie këtë:

A K T V E N D I M

I. APROVOHET marrëveshja për ndërmjetësim Nd.nr..../.. e datës, lidhur në mes të pandehurit X.... P..... dhe përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar K...- H..... me seli në P.....

II. HUDHET aktakuza e Prokurorisë Themelore ne Pejë Departamenti i Përgjithshëm PP/II nr.1093/22 të datës 13.06.2022.

III. PUSHOHET procedura penale ndaj të pandehurit **XH.... P....**, i lindur më datën në P..... tani me banim në fshatin V.... R..... i III-të, K. P....., rr. “Ç... S....”, i biri i B.... dhe nënës Sh....., posedon nr. tel dhe, i identifikuar në bazë të numrit personal, i nacionalitetit Shqiptar, shtetas i R. Kosovës.

- për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 314 par. 1 të KPRK-së.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamentit të Përgjithshme me datën 13.06.2022 ka ngritur aktakuzën PP/II nr.1093/22, ndaj të pandehurit X.... P..... për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 314 par. 1 të KPRK-së.

Me datën është arrit marrëveshja në zyrën e ndërmjetësimit në mes të pandehurit X.... P..... dhe përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar K...-sha, me seli në Pejë, e cila marrëveshje i është dozuar gjykatës ne kopje të mjaftueshme.

Nga te cekurat me lartë gjykata ka vendosur si ne pikën I të dispozitiv të këtij aktvendimi duke e pranuar marrëveshja për ndërmjetësim Nd.nr..../. e datës, lidhur në mes të pandehurit X.... P..... dhe përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar K...- H... me seli në P..., e cila marrëveshje i është dozuar gjykatës ne kopje të mjaftueshme.

Me dispozitën ligjore të nenin 229 par. 5 të KPRK-së është përcaktuar se: nëse aktakuza është dorëzuar, gjyqtari i vetëm gjykues, nëse e pranon formalisht marrëveshjen, merr vendim për të hedhur aktakuzën dhe e ndërpre në procedurën penale.

Andaj nga të cekurat më lartë e në kuptim 229 par.5 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE PEJË – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM ,
DIVIZIONI PENAL
2022:121150, 30.05.2024**

Bashkëpunëtorja Profesionale

Gj y q t a r i

Edona Berisha Kastrati

Musë Povataj

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi palët kanë te drejtë të parashtrojnë ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate, në afat prej 3 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktvendimi